REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 295, Datë 20.10.2026

MBI

DEPOZITIMIN NË ERE TË DOKUMENTACIONIT PËR TESTIMIN E VEPRËS NGA SUBJEKTET E LICENCUARA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, "*Për sektorin e energjisë elektrik*e"; si dhe nenit 15, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3080 prot., datë 15.10.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 01, datë 06.01.2025"Mbi depozitimin në ERE të dokumentacionit për testimin e veprës nga subjektet e licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",*

Konstatoi se:

- ERE, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të saj ligjore në fushën e licencimit të prodhimit të energjisë elektrike dhe në referencë të përcaktimeve në kontratat e lidhura ndërmjet subjekteve dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), ka parashikuar në vendimet respektive të licencimit detyrimin e subjekteve të licencuara për të depozituar pranë ERE-s, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i operimit, dokumentacionin që provon kryerjen e testimeve të veprës energjetike, me qëllim dokumentimin e përmbushjes së kushteve teknike dhe kontraktore, si dhe verifikimin e përfundimit dhe gatishmërisë së saj për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i praktikave të licencimit dhe zbatimit të këtij detyrimi, vlerësohet e nevojshme unifikimi i praktikës së ERE-s për depozitimin e dokumentacionit të testimit, duke marrë në konsideratë edhe parashikimet përkatëse të kontratave të lidhura me MIE-n. Për këtë qëllim, është e nevojshme të përcaktohet një standard i unifikuar, duke dalluar subjektet që do të licencohen në vijim nga ato të licencuara më parë, në funksion të momentit të licencimit dhe kushteve të përcaktuara në vendimet përkatëse.
- Sa më lart, për *grupin e subjekteve që do të licencohen në vijim, si dhe subjekteve që kanë qenë licencuar më parë, të cilat nuk e kanë filluar ende ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike dhe në vendimet respektive të licencimit të të cilave nuk është parashikuar shprehimisht detyrimi për depozitimin e testimit të veprës*, vlerësohet e nevojshme që detyrimi për depozitimin pranë ERE-s të dokumentacionit të testimit të veprës të përcaktohet shprehimisht, duke parashikuar një afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga fillimi i ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.
- Ky përcaktim synon të sigurojë një standard të unifikuar për të gjitha subjektet, duke garantuar njohjen paraprake me detyrimin dhe afatin përkatës, si dhe mundësinë e monitorimit të përmbushjes së tij nga ERE, në funksion të dokumentimit të kushteve teknike dhe të gatishmërisë së veprave për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

- Për *grupin e subjekteve të licencuara, që kanë filluar ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por nuk kanë depozituar dokumentacionin e testimit të veprës brenda afatit të përcaktuar në vendimet përkatëse,* vlerësohet se përcaktimi i një afati shtesë për depozitimin e dokumentacionit të testimit të veprës përbën një masë të përshtatshme dhe proporcionale për garantimin e përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në vendimet respektive të licencimit, duke shmangur njëkohësisht marrjen e masave që mund të cenojnë vijimësinë e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga këto centrale. Këto subjekte janë PARISOL" sh.p.k., "SAMASOL" sh.p.k., "REBESOL" sh.p.k., "ZENINA" sh.p.k., "GLOBAL TECHNICAL MECHANICS" sh.p.k. "DELIU 3D" sh.p.k., "Solar Horizon" sh.p.k. dhe "Green Energy" sh.p.k, "EZ-5 ENERGY" sh.p.k., "POWER ENERGY" sh.p.k. dhe "IDI 2005" sh.p.k
- Në këtë drejtim, duke qenë se bëhet fjalë për subjekte që kanë nisur tashmë prodhimin e energjisë elektrike dhe duke marrë në konsideratë rrethanat e njëjta që karakterizojnë rastet e tyre, vlerësohet e arsyeshme që këtyre shoqërive t'u lihet afat datë 30.11.2026, për depozitimin pranë ERE-s të dokumentacionit që provon kryerjen e testimeve të veprave.
- *Për grupin e subjekteve të licencuara, të cilat e kanë filluar ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike dhe në vendimet respektive nuk kanë pasur të parashikuar shprehimisht detyrimin për depozitimin e testimit të veprës,* vlerësojmë të sqarojmë se ligji nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", parashikonte në nenin 22 Certifikatën e Pranimit të Veprës (CPV) në kuadër të trajtimit të prodhuesve ekzistues me përparësi dhe përfitimit nga skema e mbështetjes. Në zbatim të këtij parashikimi, Udhëzimi i ministrit përgjegjës për energjinë nr. 5, datë 13.10.2020 "*Për miratimin e procedurave për lëshimin, transferimin, modifikimin ose anulimin e 'Certifikatës së pranimit të veprës' për prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike nga impiantet që përdorin energjinë nga burime të rinovueshme*, përcaktoi procedurat për lëshimin e saj. Po ashtu, MIE me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 152/5 prot., datë 19.11.2021, ka sqaruar se *CPV-ja konsiderohet e lëshuar automatikisht për të gjitha impiantet e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, të cilat janë në operim dhe kanë kryer testimin e veprës para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7/2017. Për këto kategori prodhuesish me përparësi, CPV i lëshohet në çdo rast shoqërisë koncesionare*.
- Për sa më sipër, duke qenë se ligji nr. 7/2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 26, datë 20.02.2017 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit, pra në datën 07.03.2017, vlerësohet se detyrimi për depozitimin pranë ERE-s të dokumentacionit të testimit duhet të zbatohet për subjektet që kanë filluar ushtrimin e veprimtarisë pas kësaj date. Duke marrë në konsideratë se këto subjekte disponojnë dokumentacionin përkatës, vlerësohet e arsyeshme që depozitimi i tij të kryhet deri më 31.12.2026, duke garantuar një afat të përshtatshëm për përmbushjen e detyrimit, pa cenuar vijimësinë e veprimtarisë së licencuar.
- Përcaktimi i detyrimeve dhe një afati për të gjitha kategoritë e sipërcituara synon të sigurojë një trajtim të qartë dhe të parashikueshëm të detyrimit, duke marrë në konsideratë faktin se subjektet janë licencuar në bazë të vendimeve respektive të miratuara në periudha të ndryshme dhe se afatet apo kushtet e përcaktuara në këto vendime mund të ndryshojnë nga një rast në tjetrin. Në këtë mënyrë, synohet të shmangen paqartësitë në zbatimin e detyrimit dhe të garantohet një praktikë sa më e njëtrajtshme në administrimin e tij.
- Njëkohësisht, ky përcaktim nuk cenon detyrimet që rrjedhin nga kontratat e lidhura me MIE-n dhe as kushtet e tjera të përcaktuara në aktet përkatëse të licencimit, të cilat mbeten të zbatueshme sipas kuadrit ligjor në fuqi.
- Në përfundim, duke marrë në konsideratë sa më sipër, vlerësohet e nevojshme që bordi i ERE-s të shqyrtojë dhe të miratojë unifikimin e praktikës lidhur me përcaktimin e afateve për

depozitimin e dokumentacionit të testimit të veprës, duke mbajtur në konsideratë dallimin ndërmjet subjekteve të licencuara tashmë që kanë filluar operimin dhe nuk e kanë depozituar dokumentacionin përkatës, të cilat e kanë pasur këtë detyrim të përcaktuar në vendimet respektive të licencimit, dhe subjekteve që do të licencohen në vijim, si dhe respektimin e detyrimeve kontraktore përkatëse me MIE-n dhe të kuadrit ligjor në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të gjitha subjektet që do të licencohen në vijim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, kanë detyrimin që, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i ushtrimit të veprimtarisë, të depozitojnë në ERE dokumentacionin e testimit të veprës.

2. Subjektet e licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, që nuk e kanë filluar ende ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe për të cilat vendimet e licencimit nuk parashikojnë shprehimisht detyrimin për depozitimin e dokumentacionit të testimit të veprës, duhet ta depozitojnë këtë dokumentacion brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i ushtrimit të veprimtarisë (sipas listës bashkëlidhur).

3. Subjektet e licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, që e kanë filluar ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe nuk kanë depozituar dokumentacionin e testimit të veprës brenda afatit të përcaktuar në vendimin e licencimit, duhet ta depozitojnë këtë dokumentacion brenda datës 30.11.2026 (sipas listës bashkëlidhur).

4. Subjektet e licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, që e kanë filluar ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe për të cilat vendimet e licencimit nuk parashikojnë shprehimisht detyrimin për depozitimin e dokumentacionit të testimit të veprës, duhet ta depozitojnë këtë dokumentacion brenda datës 31.12.2026 (sipas listës bashkëlidhur).

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë të licencuarit dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

Lista e subjekteve të licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, që nuk e kanë filluar ende ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe për të cilat vendimet e licencimit nuk parashikojnë shprehimisht detyrimin për depozitimin e dokumentacionit të testimit të veprës

Nr.	Subjekti	Vendimi i Bordit të ERE-s për licencimin e subjektit
1	"SOT-AL" sh.p.k.	Nr. 61, datë 02.11.2007 (transferuar nga shoqëria "HERA" sh.p.k., me vendimin e Bordit nr. 164, datë 20.06.2022)
2	"E VENTO srl Albania" sh.p.k.	Nr. 84, datë 17.07.2008
3	"FERAR" sh.p.k.	Nr. 04, datë 25.01.2011
4	"TERMOCENTRALI VLORE" sh.a	Nr. 11, datë 02.03.2009
5	"ALESIO – 2014" sh.p.k.	Nr. 34, datë 09.02.2018
6	"ALESIO – 2014" sh.p.k.	Nr. 180, datë 20.08.2018
7	"BE-IS Energy" sh.p.k.	Nr. 265, datë 20.12.2018
8	"Diezela" sh.p.k.	Nr. 16, datë 23.01.2020
9	"ELECTRAL BATRA HPP" sh.p.k.,	Nr. 42, datë 06.03.2020
10	"AGE KUÇ" sh.p.k.	Nr. 41, datë 10.03.2022
11	"Gealb Energy" sh.p.k.	Nr. 361, datë 07.12.2023
12	"AGE ERZEN" sh.p.k.	Nr. 154, datë 31.07.2024
13	"BMG ENERGY SAL" sh.p.k.	Nr. 175, datë 29.08.2024
14	"Albanian Power Core" sh.p.k.	Nr. 227, datë 28.10.2024
15	"DRIBEN" sh.p.k.	Nr. 50, datë 27.02.2025

Subjektet e licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, që e kanë filluar ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe nuk kanë depozituar dokumentacionin e testimit të veprës brenda afatit të përcaktuar në vendimin e licencimit

Nr.	Subjekti	Vendimi i Bordit të ERE-s për licencimin e subjektit
1	"PARISOL" sh.p.k.	Nr. 220, datë 23.10.2024
2	"SAMASOL" sh.p.k.	Nr. 14, datë 16.01.2025
3	"REBESOL" sh.p.k.	Nr. 15, datë 16.01.2025
4	"ZENINA" sh.p.k.	Nr. 25, datë 16.01.2025
5	"DELIU 3D" sh.p.k.	Nr. 51, datë 03.03.2025
6	"SOLAR HORIZON" sh.p.k.	Nr. 94, datë 28.04.2025

Nr.	Subjekti	Vendimi i Bordit të ERE-s për licencimin e subjektit
7	"GREEN ENERGY" sh.p.k.	Nr. 121, datë 09.06.2025
8	"EZ-5 ENERGY" sh.p.k	Nr. 171, datë 31.07.2025
9	"POWER ENERGY" sh.p.k.	Nr. 198, datë 15.08.2025
10	"GLOBAL TECHNICAL MECHANICS" sh.p.k.	Nr. 202, datë 01.09.2025
11	"IDI 2005" sh.p.k.	Nr. 289, datë 13.11.2025

Lista e subjekteve të licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, që e kanë filluar ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe për të cilat vendimet e licencimit nuk parashikojnë shprehimisht detyrimin për depozitimin e dokumentacionit të testimit të veprës

Nr.	Subjekti	Vendimi i Bordit të ERE-s për licencimin e subjektit
1	"REMI" sh.p.k.	Nr. 57, datë 11.10.2007
2	"MUSO HC QYTEZË" sh.p.k.	Nr. 91, datë 06.08.2008
3	"PURE ENERGY STEBLEVA" sh.p.k.	Nr. 61, datë 19.08.2009
4	"HEC-i Dragostunje" sh.p.k.	Nr. 25, datë 10.03.2011
5	"HENZ ENERGY" sh.p.k.	Nr. 65, datë 28.05.2012
6	"DUKA T2" sh.p.k.,	Nr. 30, datë 18.03.2013
7	"HEC TRESKA" sh.p.k.	Nr. 80, datë 24.07.2013
8	"Enrel Hydro" sh.p.k.	Nr. 41, datë 13.05.2014
9	"SA'GA MAT" sh.p.k.	Nr. 92, datë 06.10.2014
10	"AYEN AS ANERGJI" sh.p.k.	Nr. 32, datë 04.03.2015
11	"Denas Power" sh.p.k.	Nr. 120, datë 14.10.2015
12	"DRAGOBIA ENERGY" sh.p.k.	Nr. 17, datë 16.02.2016
13	"HEC Lashkiza" sh.p.k.	Nr. 41, datë 12.04.2016
14	"Liria Energji" sh.p.k.	Nr. 51, datë 29.04.2016
15	"XHENGO ENERGJI" sh.p.k.	Nr. 154, datë 06.10.2016
16	"DAAB ENERGY GROUP" sh.p.k.	Nr. 162, datë 06.10.2016
17	"ENERGJI UNIVERS" sh.p.k.	Nr. 38, datë 06.03.2017
18	"SKATINË – HEC" sh.p.k.	Nr. 108, datë 10.07.2017
19	"EUROBIZNES" sh.p.k.	Nr. 164, datë 12.10.2017
20	"THE BLUE STAR" sh.p.k.	Nr. 165, datë 12.10.2017
21	"AFRIMI K" sh.p.k.	Nr. 172, datë 12.10.2017

Nr.	Subjekti	Vendimi i Bordit të ERE-s për licencimin e subjektit
22	“SIMA COM” sh.p.k.	Nr. 194, datë 24.11.2017
23	“HEC LLËNGË” sh.p.k.	Nr. 27, datë 30.01.2018
24	“LUÇENTE-KONÇESIONARE” sh.p.k.	Nr. 60, datë 15.03.2018
25	“HYDRO SETA” sh.p.k.	Nr. 73, datë 26.03.2018
26	“FAVINA.1.” sh.p.k.	Nr. 83, datë 06.04.2018
27	“AGE SUNPOWER” sh.p.k.	Nr. 85, datë 20.04.2018
28	“Seman Sunpower” sh.p.k.	Nr. 86, datë 20.04.2018
29	“SEMAN1SOLAR” sh.p.k.	Nr. 113, datë 14.05.2018
30	“SEMAN2SUN” sh.p.k.	Nr. 114, datë14.05.2018
31	“SONNE” sh.p.k	Nr. 118, datë 04.06.2018
32	“AED SOLAR” sh.p.k.	Nr. 125, datë 04.06.2018
33	“DOMI TEC” sh.p.k.	Nr. 151, datë 03.07.2018
34	“BLAC ENERGY” sh.p.k.	Nr. 157, datë 09.07.2018
35	“DERBI-E” sh.p.k.	Nr. 195, datë 30.08.2018
36	“EDIANI” sh.p.k.,	Nr. 175, datë 03.08.2018
37	“AEE” sh.p.k.	Nr. 209, datë 27.09.2018
38	“OSOJA HPP” sh.p.k.	Nr. 228, datë 26.10.2018
39	“RTS” sh.p.k.	Nr. 13, datë 31.01.2019
40	“Smart Watt” sh.p.k.	Nr. 72, datë 10.05.2019
41	“S G D ENERGJI” sh.p.k.	Nr. 81, datë 31.05.2019
42	“SANG 1” sh.p.k.	Nr. 83, datë 31.05.2019
43	“ES 2019” sh.p.k.	Nr. 87, datë 31.05.2019
44	“SPE GJADER” sh.p.k.	Nr. 114, datë 22.07.2019
45	“IRARBA ENERGJI” sh.p.k.	Nr. 140, datë 24.09.2019
46	“MP-HEC” sh.p.k.	Nr. 187, datë 25.11.2019
47	“ELVA-2001” sh.p.k.	Nr. 217, datë 20.12.2019
48	“HEC ARSTI” sh.p.k.	Nr. 218, datë 20.12.2019
49	“HYDRO POWER PANARIT” sh.p.k.	Nr. 219, datë 20.12.2019
50	“KROI MBRET ENERGJI” sh.p.k.	Nr. 41, datë 06.03.2020
51	“ERA HYDRO” sh.p.k.	Nr. 62, datë 08.04.2020
52	“GEGA-G” sh.p.k.	Nr. 63, datë 08.04.2020
53	“KALISI HYDROPOWER” sh.p.k.	Nr. 71, datë 22.04.2020

Nr.	Subjekti	Vendimi i Bordit të ERE-s për licencimin e subjektit
54	“STATKRAFT RENEWABLES ALBANIA” sh.a	Nr. 121, datë 17.07.2020
55	“SEKA HYDROPOWER” sh.p.k.	Nr. 146, datë 10.09.2020
56	“MATEO & CO” sh.p.k.	Nr. 155, datë 07.10.2020
57	“TIRANA ENERGJI” sh.p.k.	Nr. 175, datë 04.11.2020
58	“KOKA DHE ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k.	Nr. 176, datë 04.11.2020
59	“IDI 2005” sh.p.k.	Nr. 188, datë 16.11.2020
60	“ERDY ENERGY” sh.p.k.	Nr. 240, datë 21.12.2020
61	“HEC ZALL XHUXHE” sh.p.k.	Nr. 241, datë 21.12.2020
62	“GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k	Nr. 21, datë 25.01.2021
63	“AGETA” sh.p.k..	Nr. 27, datë 29.01.2021
64	“ARIS ALBANIA” sh.p.k.	Nr. 55, datë 22.02.2021
65	“REI-ENERGJI” sh.p.k.	Nr. 83, datë 30.03.2021
66	“GERTI” sh.p.k.	Nr. 99, datë 16.04.2021
67	“BREÇANI - R.O.S.P” sh.p.k.	Nr. 09, datë 21.01.2022
68	LAJTHIZA INVEST” sh.p.k.,	Nr. 40, datë 10.03.2022
69	“HEC TERFOJA” sh.p.k.	Nr. 58, datë 31.03.2022
70	“Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (Sh.A Kesh)”	Nr. 62, datë 11.04.2022
71	"KARAVASTA SOLAR" sh.p.k.	Nr. 97, datë 09.05.2022
72	"SPV BLUE 1" sh.p.k.	Nr. 116, datë 24.05.2022
73	“VOKOPOLA ENERGJI” sh.p.k.,	Nr. 161, datë 17.06.2022
74	"NTSP" sh.p.k.	Nr. 190, datë 21.07.2022
75	"KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK" sh.p.k	Nr. 191, datë 21.07.2022
76	“TREN SUN SYSTEM” sh.p.k.	Nr. 192, datë 21.07.2022
77	"SUN BEAT SYSTEM" sh.p.k.	Nr. 193, datë 21.07.2022
78	"GREEN ENERGY BILISHTI" sh.p.k.	Nr. 194, datë 21.07.2022
79	"EZ-5 ENERGY” sh.p.k.	Nr. 237, datë 22.09.2022
80	“EGNATIA HYDROPOWER” sh.p.k.	Nr. 248, datë 29.09.2022
81	"ERNI SOLAR" sh.p.k.	Nr. 304, datë 25.11.2022
82	“CONSTRUCTION ENERGY PARTS (C.E.P)” sh.p.k.	Nr. 306, datë 30.11.2022
83	"HYDROPOWER" sh.p.k.	Nr. 307, datë 30.11.2022

Nr.	Subjekti	Vendimi i Bordit të ERE-s për licencimin e subjektit
84	“DIMAX ALBANIA” sh.p.k.	Nr. 308, datë 30.11.2022
85	“ALBSOLAR” sh.p.k.	Nr. 320, datë 12.12.2022
86	“BIGWIND” sh.p.k.	Nr. 332, datë 19.12.2022
87	“SUN AVENUE” sh.p.k.	Nr. 72, datë 13.03.2023
88	“SUNPOWER 2017” sh.p.k.	Nr. 73, datë 13.03.2023
89	“ATEANI ENERGJI” sh.p.k.	Nr. 107, datë 23.03.2023
90	“TPLANI HC” sh.p.k.	Nr. 111, datë 27.03.2024
91	"Sun Energy Solutions" sh.p.k.	Nr. 123, datë 04.04.2023
92	"Erseka Solar Park 1" sh.p.k.	Nr. 176, datë 18.05.2023
93	"NOVA SOLAR SYSTEM"sh.p.k.	Nr. 242, datë 03.08.2023
94	"ALB SUN ENERGY" sh.p.k.	Nr. 250, datë 16.08.2023
95	“Erseka Solar Park 2” sh.p.k.	Nr. 253, datë 23.08.2023
96	“G.S.K” sh.p.k.	Nr. 254, datë 23.08.2023
97	“Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k.”	Nr. 268, datë 11.09.2023
98	“IDI 2005” sh.p.k.	Nr. 303, datë 23.10.2023
99	“GERTI” sh.p.k.	Nr. 362, datë 07.12.2023
100	“IDI 2005” sh.p.k.	Nr. 30, datë 27.03.2024
101	“HEC Polemi” sh.p.k.	Nr. 77, datë 29.04.2024 (transferuar nga “DRINI BULQIZE” sh.p.k. me vendimin nr. 227, datë 10.08.2026)
102	“FU-GEN" sh.p.k.	Nr. 122, datë 19.06.2024
103	"GreeNNat Solar Park Ballsh" sh.p.k.	Nr. 132, datë 02.07.2024
104	"5GX ENERGY" sh.p.k	Nr. 135, datë 09.07.2024
105	“H.K HEC Grabova 2” sh.p.k.	Nr. 157, datë 31.07.2024
106	"Nova Prospect" sh.p.k.	Nr. 164, datë 15.08.2024
107	"SUN’S MIRACLE" sh.p.k.	Nr. 168, datë 26.08.2024
108	“ACHELO” sh.p.k.	Nr. 176, datë 29.08.2024
109	"MAGNA SOLAR POWER" sh.p.k.	Nr. 181, datë 12.09.2024
110	“SLR ALBANIA” sh.p.k.	Nr. 262, datë 02.12.2024
111	“M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k.	Nr. 276, datë 13.12.2024
112	"SPV BLUE 2" sh.p.k.	Nr. 296, datë 30.12.2024
113	"3AD Energy" sh.p.k.	Nr. 01, datë 06.01.2025
114	"DESLA" sh.p.k.	Nr. 02, datë 06.01.2025
115	“Sunny Side Energy” sh.p.k.	Nr. 13, datë 16.01.2025

Nr.	Subjekti	Vendimi i Bordit të ERE-s për licencimin e subjektit
116	“MER ENERGJI” sh.p.k.	Nr. 29, datë 03.02.2025